

KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot në Tiranë, më datë 04/01/2021, palët e mëposhtme lidhën këtë kontratë shitje kuote (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”), si vijon:

- **Znj. Zhuljeta Ndrico**, shtetase shqiptare, lindur në Gjirokastrë më datë 03.11.1984, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 034748893 dhe me nr. personal I46103012T, madhor me zotësi juridike për të vepruar; (këtu e në vijim referuar si “Shitësi” ose “Zhuljeta Ndrico”),

Dhe

- **Shoqëria “MORPH” SH.P.K**, person juridik i të drejtës shqiptare, themeluar më datë 21.09.2020 dhe regjistruar në regjistrin tregtar më datë 24.09.2020, me NIPT M02124027C, përfaqësuar nga **Administratori z. Klodian Makashi**, me zyrë qendrore në adresën “Rruga e Kavajës”, Qendra Sun Tower, mbi Raiffeisen Bank, Kati 8, Ap. 45, Tiranë. (këtu e në vijim referuar si “Blerësi” ose “MORPH”).

Në këtë kontratë veç e veç referuar si “Pala” dhe së bashku referuar si “Palët”.

Të Dhëna Paraprake

A) Zhuljeta Ndrico është ortakë dhe zotëruese e 1 (një) kuote, që përfaqëson 100 (njëqind) pjesë dhe 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë “REDCLOUD” SH.P.K, me (NIPT) NUIS L11331001C, me kapital ALL 100.000 (njëqind mijë) Lekë, themeluar më datë 27.01.2011 dhe regjistruar në regjistrin tregtar më datë 31.01.2011, me seli në Rruga “Thoma Koxhaj”, Ndërtesa 11, Hyrja 28, Ap.29, Kashar, Tiranë, Shqipëri (bazuar në ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit në datën e lidhjes së kësaj kontrate).

B) Zhuljeta Ndrico dëshiron të shesë 100% (njëqind për qind) të kuotës së saj në shoqërinë “REDCLOUD” Sh.p.k me (NIPT) NUIS L11331001C tek Blerësi MORPH dhe Blerësi MORPH dëshiron të blejë 100% (njëqind për qind) të kuotës së Zhuljeta Ndrico në shoqërinë “REDCLOUD” Sh.p.k me (NIPT) NUIS L11331001C, në mënyrë që pas shitjes Zhuljeta Ndrico nuk do të ketë më asnjë zotërim mbi asnjë kuotë në shoqërinë “REDCLOUD” Sh.p.k me (NIPT) NUIS L11331001C, dhe Blerësi MORPH do të zotërojë 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 (njëqind) pjesë dhe 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë “REDCLOUD” SH.P.K, me (NIPT) NUIS L11331001C.

ATËHERË, duke marrë parasysh sa më lart, për të cilat Palët janë dakord e nuk kanë pretendime, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës/Kalimi i pronësisë së Kuotës nëpërmjet shitjes

1.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi Zhuljeta Ndrico i shet Blerësit MORPH dhe Blerësi MORPH pranon të blejë nga Shitësi Zhuljeta Ndrico 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 (njëqind) pjesë dhe 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë “REDCLOUD” SH.P.K, me (NIPT) NUIS L11331001C, themeluar më datë 27.01.2011 dhe regjistruar në regjistrin tregtar më datë 31.01.2011, me seli në Rruga “Thoma Koxhaj”, Ndërtesa 11, Hyrja 28, Ap.29, Kashar, Tiranë, Shqipëri, dhe çdo të drejtë që buron prej saj, bashkë me çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor i të tretëve mbi të, në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Kontratë (“Kuota e Shitur”).

1.2 Pronësia e Kuotës së Shitur do të kalojë nga Shitësi Zhuljeta Ndrico tek Blerësi MORPH menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pa qenë nevoja për pagesën e çmimit të shitjes sipas nenit 2 dhe 3 mëposhtë të kësaj Kontrate.

1.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kështu pas shitjes së Kuotës së Shitur, Shitësi Zhuljeta Ndrico nuk do të ketë më asnjë zotërim mbi asnjë kuotë në shoqërinë “REDCLOUD” Sh.p.k me (NIPT) NUIS L11331001C, dhe



Blerësi MORPH do të zotërojë 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 (njëqind) pjesë dhe 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "REDCLOUD" SH.P.K, me (NIPT) NUIS L11331001C.

Neni 2
Çmimi i Shitjes

Blerësi MORPH do t'i paguajë Shitësit Zhuljeta Ndrico për Kuotën e Shitur, sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, çmimin total të shitjes prej ALL 100.000 (njëqind mijë) Lekë ("**Çmimi i Shitjes**").

Neni 3
Mënyra, Afatet dhe Kushtet e Pagesës

Çmimi i Shitjes do të paguhet në totalitet në gjithsej 1 (një) kësht nga Blerësi MORPH në favor të Shitësit Zhuljeta Ndrico, brenda një afati (10) dhjetë ditor nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, me para në dorë ose në llogarinë bankare të Shitësit Zhuljeta Ndrico. Pronësia e Kuotës së Shitur do të kalojë tek Blerësi MORPH menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pa qenë nevoja për pagesën e Çmimit të Shitjes.

Neni 4
Data Efektive

Palët bien dakort që depozitimi i aplikimit përkatës për regjistrimin e kalimit të kuotës në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**") do të kryhet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate. Palët bien dakort në mënyrë të pakushtëzuar se pronësia e Kuotës së Shitur nga Shitësi Zhuljeta Ndrico tek Blerësi MORPH do të transferohet/kalohet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pa qenë nevoja për pagesën e Çmimit të Shitjes.

Neni 5
Tatime e Taksa

Të gjithë taksat/tatimet dhe detyrimet e tjera shtetërore që burojnë nga kjo Kontratë paguhet nga Blerësi MORPH.

Neni 6
Të ndryshme

6.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe hartohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Të gjithë mosmarrëveshjet që do të lindin lidhur me këtë Kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim mes Palëve, dhe nëse nuk arrihet në mirëkuptim, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.2 Kjo Kontratë, përbën të gjithë marrëveshjen midis Palëve në lidhje me objektin e saj. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim nga Palët.

6.3 Kjo Kontratë nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila.

SHITËSI
Zhuljeta NDRICO

Zhuljeta Ndrico



BLERËSI
Shoqëria "MORPH" SH.P.K
Administratori
Klodian MAKASHI

Klodian Makashi

